

LIGJ Nr. 143/2015 date 17.12.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9136, DATË 11.9.2003,
“PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

Në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9, të këtij ligji, nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor.”.

Neni 2

Në nenin 7, në fund të paragrafit të parë shtohen fjalët “për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave”.

Neni 3

Në nenin 8, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 4

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

**Llogaritja e kontributeve për personin e vetëpunësuar
dhe punonjësin e papaguar të familjes**

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi pagën minimale, të miratuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor, për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi dyfishin e pagës minimale, të miratuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, përfshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit shëndetësor, nga paga minimale deri në pagën maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave. Kriteret e përcaktimit të pagës, për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mbajnë parasysh llojin e profesionit, numrin e të punësuarve, zonën ku zhvillohet aktiviteti ekonomik, nivelin e të ardhurave në sektorin publik për profesione të njëjta ose të ngjashme, eksperiencën në profesion dhe statusin e profesionistit. Këshilli i Ministrave nxjerr vendim për zbatimin e këtij paragrafi.

2. Në rast se veprimtaria ekonomike ndërpritet për një periudhë, vlera e kontributit për t'u paguar zvogëlohet përpjesëtimisht, në përputhje me formulën e përcaktuar në udhëzimet e Ministrit të Financave, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 5

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, dhe gjobat përkatëse përcaktohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 6

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2016.

Miratuar në datën 17.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9395 , datë 7.1.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Botuar ne F.Zyrtare 244/2015

Dale nga shtypi me 11.01.2016